



Përmbyllet me sukses stërvitja shumëkombëshe “Defender Europe 25”



» faqe 3



SHSHPFA, GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI: SHPEJTËSIA E REAGIMIT SHPËTON JETË, NGA MINUTA E ARTË NË OPERACIONET SAR, TE ORA KRITIKE NË EMERGJENCAT CIVILE

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, priti në një takim zyrtar zëvendëskomandantin e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, gjeneral brigade LaPoint, dhe zëvendës drejtorin e Planifikimit të Komandës së Forcave... » faqe 2



ARKIV I RI USHTARAK NË TIRANË: QEVERIA MIRATON KRIJIMIN E ARKIVIT QENDROR PËR DOKUMENTACIONIN TEKNIK TË ARMATIMIT

Këshilli i Ministrave miratoi krijimin e Arkivit Qendror në Veprim për Dokumentacionin Teknik të Tipologjisë së Veçantë të Armatimit dhe Pajisjeve Teknologjike Ushtarake, një strukturë e re që do të administrohet nga Ministria e Mbrojtjes dhe do të ketë selinë në kryeqytet... » faqe 3



AGRON GOGA: BUZËQESHJA QË LIND NGA DHIMBJA

INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Agron Goga: Ushtar i Disiplinës, Shkrimtar i Humorit, Babai i Dy Zemrave. Në një kohë kur fjala po bëhet gjithnjë e më bosh, ai e përdor atë si bisturi të mendjes dhe zemrës. Agron Goga nuk është thjesht një emër në librat e humorit apo në listat e skenaristëve të suksesshëm shqiptarë. Ai është një nga ata njerëz që të bënë të qeshësh dhe të mendosh menjëherë pas buzëqeshjes... » faqe 6

Takim i lartë ushtarak në Tiranë, thellohet bashkëpunimi strategjik Shqipëri–SHBA

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, priti në një takim zyrtar zëvendëskomandantin e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, gjeneral brigade LaPoint, dhe zëvendësrektorin e Planifikimit të Komandës së Forcave Amerikane për Evropën (USEUCOM), gjeneral brigade McKinney.

Ky takim erdhi menjëherë pas përfundimit të stërvitjes shumëkombëshe “Defender Europe-25”, ku të dy gjeneralët amerikanë morën pjesë në “Ditën e Vizitorëve të Shquar”, me ftesë të gjenerallejtënant Kingjit. Në këtë stërvitje, Shqipëria luajti rolin e vendit mikpritës, ndërkohë që në të morën pjesë edhe personel nga Garda Kombëtare e Nju Xhersit dhe Forca Detare e SHBA-së. Në fokus të takimit ishin vijimi i bashkëpunimit dypalësh, me theks të veçantë në zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse, trajnimeve të përbashkëta, stërvitjeve dhe projekteve të modernizimit të FARSH-së. Gjenerallejtënant Kingji vlerësoi kontributin e rëndësishëm të SHBA-ve për rritjen e ndërveprueshmërisë dhe profesionalizmit të personelit shqiptar, duke përmendur veçanërisht



mbështetjen nga USEUCOM dhe Garda e Nju Xhersit në fusha kyçe si trajnimi, mirëmbajtja dhe logjistika. Në fjalën e tij, gjenerallejtënant Kingji shprehu falënderim të veçantë për Komandën e Forcave Amerikane për Evropën dhe Afrikën, për zgjedhjen e Shqipërisë për të tretën herë radhazi si vend mikpritës të një prej stërvitjeve më të rëndësishme të NATO-s. Ai e cilësoi këtë si një dëshmi të qartë të partneritetit strategjik mes Shqipërisë dhe SHBA, dhe si një kontribut të drejtpërdrejtë në rritjen e sigurisë dhe stabilitetit në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë. Në përmbyllje të takimit, palët ritheksuan vullnetin për thellimin e bashkëpunimit ushtarak, duke theksuar se angazhimi i SHBA-ve mbetet i pazëvendësueshëm për forcimin e sigurisë rajonale dhe euroatlantike. Vizita e gjeneralëve LaPoint dhe McKinney vijoi në Komandën e Forcës Tokësore dhe Komandën e Forcës Ajrore, ku u pritën nga komandantët respektivë. Ata u njohën nga afër me zhvillimet më të fundit në këto njësi si dhe me ecurinë e projekteve të përbashkëta me SHBA-të, duke nënvizuar edhe një herë rëndësinë e partneritetit strategjik në fushën e mbrojtjes.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, i shoqëruar nga komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Aleksandër Pando, ndoqi nga afër një demonstrim të gjerë të operacioneve praktike në terren, të organizuar nga strukturat e FARSH-së.

Qëllimi i këtij demonstrimi ishte testimi i kapaciteteve reale operacionale dhe gatishmëria për të përballuar situatat e emergjencave civile, përfshirë edhe operacionet e kërkim-shpëtimit (SAR), si dhe sigurimi i një mbështetjeje efikase ndaj autoriteteve civile në rastet e fatkeqësive natyrore apo industriale. Gjenerallejtënant Kingji vlerësoi maksimalisht të gjithë efektivet pjesëmarrës për nivelin e lartë të përgatitjes, profesionalizmit dhe gatishmërisë për të reaguar me efikasitet në mbrojtje të jetës dhe sigurisë së qytetarëve shqiptarë. “Ky demonstrim jo vetëm që dëshmoi përgatitjen teknike dhe pajisjet moderne me të cilat janë të pajisura këto struktura, por mbi të gjitha tregoi vendosmërinë për të reaguar në kohë, për të shpëtuar jetë dhe për të ofruar ndihmën në momentet më kritike”, – theksoi gjenerallejtënant Kingji.

Ai nënvizoi se Baza e Mbështetjes dhe e Emergjencave Civile dhe Detashmenti i

SHSHPFPA, gjenerallejtënant Arben Kingji: Shpejtësia e reagimit shpëton jetë, nga minuta e artë në operacionet SAR, te ora kritike në Emergjencat Civile



Mbrojtjes Rajonale, të Komandës Mbështetëse, përfaqësojnë tashmë një kapacitet jo vetëm të specializuar, por një instrument operacionalo-

strategjik të Shtabit të Përgjithshëm dhe të AKMC-së për parandalimin, reagimin dhe rimëkëmbjen nga pasoja të emergjencave.

“Demonstrimet si ky nuk janë vetëm prova të aftësisë operacionale, por edhe platforma për trajnim, reflektim dhe përmirësim. Ato duhet të organizohen rregullisht, me skenarë të shumtë dhe realistë, duke përfshirë të gjitha kapacitetet e FARSH-së, si dhe bashkëpunimin me agjencitë shtetërore, jo-shtetërore dhe partnerët ndërkombëtarë”, – u shpreh Shefi i Shtabit të Përgjithshëm.

Në fund të aktivitetit, gjenerallejtënant Kingji garantoj se do të vijojë investimi për modernizimin e mëtejshëm të kapaciteteve, duke përfshirë automjete për terrene të vështira, dronë të specializuar dhe pajisje të avancuara për lokalizim në operacione komplekse.

Duke falënderuar trupat për përkushtimin e tyre, ai theksoi rëndësinë e filozofisë operacionale të strukturave të Mbrojtjes Rajonale: “Shpejtësia e reagimit shpëton jetë, nga minuta e artë në operacionet SAR, te ora kritike në Emergjencat Civile”.



Këshilli i Ministrave miratoi krijimin e Arkivit Qendror në Veprim për Dokumentacionin Teknik të Tipologjisë së Veçantë të Armatimit dhe Pajisjeve Teknologjike Ushtarake, një strukturë e re që do të administrohet nga Ministria e Mbrojtjes dhe do të ketë selinë në kryeqytet.

Sipas vendimit qeveritar, arkivi do të ketë misionin e ruajtjes, përpunimit, administrimit, digjitalizimit dhe shërbimit të dokumentacionit teknik që lidhet me municionet, prodhimin e armëve dhe çdo dokument që i shërben industrisë ushtarake të vendit.

Ky institucion i ri do të merret me tërheqjen, administrimin, deklasifikimin dhe shërbimin e dokumentacionit teknik të klasifikuar në kategorinë e “tipologjisë së veçantë”, në përputhje me legjislacionin për arkivat dhe informacionin e klasifikuar.

Në fokusin e këtij arkivi do të jetë edhe digjitalizimi i dokumentacionit dhe menaxhimi

Arkiv i ri ushtarak në Tiranë: Qeveria miraton krijimin e Arkivit Qendror për Dokumentacionin Teknik të Armatimit



modern i të dhënave, duke garantuar akses për qytetarët dhe subjektet e interesuara, në përputhje me kuadrin ligjor dhe kundrejt pagesës. Shërbimi arkivor do të përfshijë dokumente të njësuara me

originalin dhe mundësi shfrytëzimi të tyre nga publiku apo institucionet. Vendimi përcakton gjithashtu se: Dokumentacioni do të ruhet deri në 115 vjet, ndërsa dokumentet

e klasifikuara do të dorëzohen përfundimisht në arkivin e përhershëm jo më vonë se 120 vjet pas krijimit të tyre, vetëm pas deklasifikimit. Arkivi do të ketë stemën, vulën dhe logon e vet zyrtare. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes. Vendimi do të hyjë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet e Forcave të Armatosura janë ngarkuar me zbatimin e tij. Krijimi i këtij arkivi shënon një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të administrimit të dokumentacionit ushtarak, duke rritur transparencën, ruajtjen e trashëgimisë teknike dhe përgatitjen për sfidat e reja në fushën e sigurisë dhe teknologjisë ushtarake.

Tiranë, 12 qershor 2025 – Stërvitja e përbashkët shumëkombëshe “Defender Europe 25” është përmbyllur me një ceremoni zyrtare të organizuar në kuadër të Ditës së Vizitorëve të Shquar, ku morën pjesë personalitete të larta nga Shqipëria dhe vendet partnere të NATO-s. Në aktivitet morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, e ngarkuara me punë e SHBA-ve në Shqipëri, znj. Nancy Van Horn, zëvendësministri i Mbrojtjes z. Enkelejd Joti, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, gjeneral brigade LaPoint, gjeneral brigade McKinney, si dhe anëtarë të Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare dhe drejtues të forcave ushtarake nga vendet pjesëmarrëse.

Të pranishmit ndoqën nga afër disa nga demonstrimet taktike të realizuara nga trupat, të cilat janë pjesë e skenarëve operativë të “Defender Europe 25”, një nga stërvitjet më të mëdha për forcimin e sigurisë kolektive në rajonin euroatlantik.

Në fjalën e tij përshëndetëse, gjenerallejtënant Arben Kingji vlerësoi rolin aktiv dhe profesional të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, si dhe bashkëpunimin me aleatët ndërkombëtarë.

Ai theksoi se kjo stërvitje demonstroi gatishmërinë, ndërveprueshmërinë dhe kapacitetin reagues të forcave pjesëmarrëse në mjedise operationale të ndërlikuara:

“Ky bashkëpunim i vazhdueshëm është

Përmbyllet me sukses stërvitja shumëkombëshe “Defender Europe 25”



“DEFENDER EUROPE - 25’ KONFIRMOI EDHE NJË HERË ANGAZHIMIN E PALËKUNDUR TË SHTETEVE TË BASHKUARA SI ALEAT STRATEGJIK NË FORCIMIN E SIGURISË RAJONALE DHE EUROATLANTIKE”.



një dëshmi e qartë e partneritetit strategjik dhe përkushtimit për sigurinë rajonale dhe euroatlantike”, – tha gjenerallejtënant Kingji.

Stërvitja u zhvillua në disa vende të rajonit, përfshirë Shqipërinë, Kosovën, Kroacinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, me fokus në zhvillimin e aftësive për operatione të spektrit të plotë, përfshirë dislokimin e shpejtë të forcave, mbrojtjen nga kërcënime konvencionale e jokonvencionale dhe mbështetjen e infrastrukturës kritike.

Forcat shqiptare patën një rol qendror në drejtimin e operationeve nga baza e Zall-

Herrit, në bashkëpunim me oficerë të SHBA, Kosovës dhe Kroacisë. Gjenerallejtënant Kingji falënderoi veçanërisht Komandën e Forcave Amerikane për Evropën dhe Afrikën për përzgjedhjen e Shqipërisë si vend mikpritës për të tretin vit radhazi:

“‘Defender Europe - 25’ konfirmoi edhe një herë angazhimin e palëkundur të Shteteve të Bashkuara si aleat strategjik në forcimin e sigurisë rajonale dhe euroatlantike”, – u shpreh ai, duke shtuar se përgjigjja më efektive ndaj kërcënimeve moderne mbetet bashkëpunimi operacional dhe partneriteti afatgjatë.



Anija P-134 “Butrinti” zhvilloi stërvitje në detin Egje

Anija P-134 “Butrinti”, pjesë e misionit në Detin Egje, realizoi një stërvitje në ujërat ndërkombëtare me anijen flamurtare gjermane A1437 “PLANET”, me synim përmirësimin e manovrimit të përbashkët dhe forcimin e bashkëpunimit detar.

Në kuadër të këtij angazhimi, u krye shkëmbim personeli ndërmjet dy anijeve, ndërsa komandanti i P-134 zhvilloi një vizitë në bordin e “PLANET”. Ky bashkëpunim shënon një tjetër hap drejt forcimit të partneritetit ndërkombëtar dhe rritjes së gatishmërisë operacionale të Forcës Detare/Rojës Bregdetare.



Misioni FOCOPS 25-3 përmbyllet me sukses

Efektivët e anijes “LISSUS” P-133 janë kthyer në atdhe pas përfundimit me sukses të misionit FOCOPS 25-3. Në një ceremoni të veçantë, ata u pritën nga Komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetare, nënadmiral Adnand Agastra, i cili i përgëzoi për përkushtimin, profesionalizmin dhe punën e palodhshme që treguan gjatë kohës së operacionit.

Ky mision shënoi gjithashtu një moment të rëndësishëm bashkëpunimi ndërkombëtar, pasi për herë të parë mori pjesë edhe një oficer nga Mali i Zi, Lejtnant Filip Čorać, i cili shërbeu në bordin e anijes “LISSUS” gjatë misionit, duke kontribuar në shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit detar mes vendeve partnere.

Forca Detare vijon të jetë një kontribuuese e rëndësishme në operacionet ndërkombëtare të sigurisë detare, duke dëshmuar profesionalizëm dhe përkushtim të lartë në çdo angazhim jashtë vendit.



Stërvitja “Defender Europe 25” – Operacion i përbashkët detar në Gjirin e Durrësit

Në kuadër të stërvitjes shumëkombëshe “Defender Europe 25”, në Gjirin e Durrësit u zhvillua një demonstrim i operacioneve të ndalimit detar (MIO), me pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave Detare të SHBA-së.

Stërvitja u ndoq nga komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetar, nënadmiral Adnand Agastra, komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, komandant i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dimo!

Operacioni simuloi ndalimin, marrjen në kontroll, inspektimin dhe shoqërimin e një anijeje të dyshuar. Mjetet detare shqiptare, në bashkëpunim me ato të SHBA-së, kryen ndalimin e anijes, ndërsa skuadra e Regjimentit të Operacioneve Speciale realizoi bordimin vertikal përmes helikopterëve të Forcës Ajrore. Pas marrjes në kontroll të objektivit, veprimet vijuan me grupin e bordimit të Forcës Detare, i cili, pas inspektimit të hollësishëm, shoqëroi anijen drejt portit. E gjithë ndërhyrja u mbikëqyr nga dronë të Forcës Ajrore, të cilët transmetuan pamje live në Shtabin e Brigadës Shumëkombëshe në Zall-Herr, duke garantuar një ndërveprim të përkryer ndërmjet strukturave pjesëmarrëse. Ky demonstrim tregoi edhe një herë nivelin e lartë të ndërveprueshmërisë së Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me flotën e SHBA-së për garantimin e sigurisë detare në kuadër të operacioneve të përbashkëta.



Komandanti i FAj, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, priti komandantin e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Mike LaPoint

Në mjediset e Bazës Ajrore Farkë, Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, priti në një vizitë pune zëvendëskomandantin e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Mike LaPoint. Kjo vizitë e rëndësishme erdhi menjëherë pas përfundimit të stërvitjes DE-25, duke thelluar lidhjet dhe bashkëpunimin mes dy palëve. Gjeneral Dimo falënderoi ushtarakët amerikanë për mbështetjen dhe kontributin e dhënë gjatë stërvitjes dhe shprehu mirënjohje për bashkëpunimin e frytshëm në fushën ushtarake dhe logjistike. Ai theksoi se ndihmesa e Gardës Kombëtare të New Jersey-it ka qenë thelbësore në ngritjen e aftësive operacionale të Forcës Ajrore Shqiptare. Gjatë vizitës, gjeneral LaPoint dhe ekipi që e shoqëronte u njohën nga afër me misionin, strukturën dhe historikun e Forcës Ajrore Shqiptare. Dy prezantime të detajuara ofruan një pasqyrë të plotë mbi misionin dhe kapacitetet e përgjithshme të Forcës Ajrore, si dhe mbi Bazën Ajrore të Farkës, duke përfshirë ndryshimet e fundit, përmirësimet infrastrukturore dhe planet për të ardhmen. Baza Ajrore e Farkës u prezantua si një element kyç në kapacitetet operacionale të Forcës Ajrore, duke ofruar një infrastrukturë të avancuar dhe kushtet e duhura për stërvitje dhe operacione të përbashkëta. Diskutimet u përqendruan në bashkëpunimin mes dy palëve, veçanërisht në mbështetjen dhe mbarëvajtjen e projektit të helikopterëve “Blackhawk”, ku pala amerikane e Gardës Kombëtare të New Jersey-it luan një rol të rëndësishëm. U vlerësua rëndësia e mbështetjes teknike dhe logjistike që ofrohet për këtë projekt, si dhe bashkëpunimi i ngushtë për sigurimin e funksionimit efektiv dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij kapaciteti. Delegacioni amerikan pati gjithashtu mundësinë të vizitonte hangarët dhe ambientet e tjera të Bazës Ajrore të Farkës, ku u njohën nga afër me kapacitetet operacionale dhe infrastrukturën që kjo bazë ofron. Në përfundim të vizitës, gjeneral brigade Mike LaPoint shprehu vlerësimet e tij për angazhimin dhe profesionalizmin e personelit të Forcës Ajrore Shqiptare gjatë stërvitjes DE-25, duke theksuar rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit mes Gardës Kombëtare të New Jersey-it dhe Forcës Ajrore Shqiptare në kuadër të programit të partneritetit.



Përfundon me sukses stërvitja “Immediate Response-25”

Stërvitja shumëpalëshe “Immediate Response-25”, pjesë e stërvitjes “Defender Europe- 25”, shënoi një tjetër arritje të rëndësishme për Forcën Ajrore. Përgjatë ditëve të stërvitjes, Forca Ajrore tregoi profesionalizëm dhe gatishmëri të lartë, duke kontribuar me 4 helikopterë “Cougar” dhe “Blackhawk”, si dhe një mjet fluturues pa pilot (UAV).

Në Ditën e Vizitorëve të Shquar, të ftuarit ndoqën disa nga demonstrimet e trupave në kuadër të kësaj stërvitjeje. Angazhimi i Forcës Ajrore përfshiu disa skenarë kompleksë, që testuan aftësitë dhe përgatitjen e personelit për situata emergjente dhe operacione të ndërlikuara. Një nga momentet më të spikatura të stërvitjes ishte zbatimi i teknikës së zbarkimit “Fast Rope”. Kjo teknikë, e cila lejon vendosjen e shpejtë të forcave në terrene të vështira, u realizua me sukses, duke dëshmuar fleksibilitetin dhe aftësinë e lartë të pilotëve dhe trupave mbështetëse. Gjithashtu, u demonstrua evakuimi i të plagosurve në kushte emergjente, një proces i rëndësishëm që kërkon koordinim të ngushtë dhe reagim të shpejtë për të siguruar mbijetesën e të lënduarve në situata kritike. Një element tjetër i rëndësishëm ishte mbikëqyrja ajrore dhe zbulimi i situatave përmes mjetit fluturues pa pilot/UAV. Ky mjet bashkëkohor siguroi informacion të detajuar nga ajri, duke mbështetur vendimmarrjen dhe veprimet operacionale të stërvitjes. Pamjet live nga zona e Bizës, të transmetuara në ekranet e dedikuara për vizitorët e shquar, ofruan një perspektivë të qartë të fushëbetejës, duke pasqyruar efikasitetin e përdorimit të teknologjisë në operacione ushtarake.



Stërvitja “Immediate Response-25”, theksoi gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar. Pjesëmarrja aktive në këtë stërvitje shumëpalëshe pasqyroi përkushtimin e Forcës Ajrore ndaj aleancës dhe sigurisë rajonale. Ky angazhim dëshmoi edhe njëherë se Forca Ajrore është një partner i besueshëm dhe e përgatitur për të përmbushur detyrime të ndërlikuara në bashkëpunim me aleatët. Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, e cilësoi stërvitjen e trupave shqiptare krahas atyre amerikane si e suksesshme, duke u shprehur se: “Tashmë jemi një trupë e mirë stërvitur, e mirë trajtuar edhe nga ana sociale. Për shkak të karakterit, ndjenjës, dashurisë për flamurin, për vendin, veprimet tona i sinkronizojmë në maksimumin e mundshëm me risk sa më të vogël”.

Me përfundimin e kësaj stërvitjeje, Forca Ajrore konfirmoi edhe njëherë rolin e saj si një aktor i rëndësishëm në garantimin e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Përkushtimi ndaj modernizimit, trajtimit të sfidave dhe ngritjes së kapaciteteve operacionale mbetet prioritet, duke siguruar kështu stabilitet dhe mbrojtje për vendin dhe partnerët.

FORCAT E

Armatosura



DEFENDER
EUROPE
2025



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

**Agron Goga: Ushtar i Disiplinës,
Shkrimtar i Humorit, Babai i Dy Zemrave**

Në një kohë kur fjala po bëhet gjithnjë e më bosh, ai e përdor atë si bisturi të mendjes dhe zemrës. Agron Goga nuk është thjesht një emër në librat e humorit apo në listat e skenaristëve të suksesshëm shqiptarë. Ai është një nga ata njerëz që të bën të qeshësh dhe të mendosh menjëherë pas buzëqeshjes.

Për dekada me radhë, Goga ka qenë njeriu pas kamerës, pas skenës, pas asaj të qeshure që e kemi ndarë në shtëpitë tona, nga telekomeditë, te videot humoristike, deri te skeçet ikonike të “Portokallisë” dhe “Alpazarit”. Por shumë pak prej nesh kanë njohur burrin që, pas buzëqeshjeve publike, ka përballuar humbje të thella personale.

Para disa vitesh, jeta i mori bashkëshorten, shoqen e tij të jetës dhe lexuesen e parë të çdo teksti. Sot jeton me dy fëmijët e tij, i përkushtuar ndaj tyre si prind dhe si mik, duke ndërtuar për ta një botë ku dashuria, kujtimi dhe buzëqeshja nuk mungojnë asnjëherë. E pikërisht nga kjo plagë e tij e heshtur, ka lindur një thellësi tjetër në krijimtarinë e tij, një përzierje e rrallë e dhimbjes me butësinë, e të vërtetës me ironinë.

Në këtë intervistë Agron Goga flet pa rezerva, për artin, për humbjen, për jetën pas dhimbjes dhe për forcat që e mbajnë në këmbë. Ky është një rrëfim i sinqertë për ata që dinë të qeshin edhe kur jeta i ka mësuar të qajnë.

Në botën e artit dhe satirës shqiptare, emri i Agron Gogës nuk kalon pa u ndalur. Një jetë ndërmjet uniformës ushtarake dhe penës së mprehtë, ndërmjet zërit të komandës dhe zërit të humorit. Por përtej krijimtarisë së pasur, ai është edhe një baba që sot jeton me dy fëmijët e tij, pas humbjes së bashkëshortes disa vite më parë, një plagë që e ka bërë më të ndjeshëm, më të thellë dhe më njerëzor.


Agron Goga është një shkrimtar, humorist dhe oficer i Forcave të Armatosura të Shqipërisë, i njohur për kontributin e tij të pasur në letërsinë satirike dhe humoristike shqiptare. I lindur më 2 nëntor 1961, në Roskovec të Fierit, ai ka ndjekur një karrierë të gjatë ushtarake dhe artistike.

Arsimi dhe Karriera Ushtarake

Agron Goga përfundoi Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej” (1976–1980) dhe Akademinë Ushtarake (1981–1984). Më pas ndoqi trajnime në vende të ndryshme të NATO-s, duke u specializuar në marrëdhëniet civilo-ushtarake dhe komunikimin me publikun dhe median. Pas një karriere ushtarake deri në vitin 1994, ai u emërua shef i marrëdhënieve me publikun në Forcën Detare (1994–2007), më pas shef i sektorit të Multimedias në Qendrën Kulturore të Forcave të Armatosura (2007–2013), dhe që nga viti 2013 punon në sektorin e aktiviteteve në Qendrën e Kulturës së FARSH-së.



Buzëqeshja që lind nga dhimbja



Vëllime me tregime humoristike: “Vetëvrasja e Gomarit”; “Si nuk u ngrit një bust për mua!”; “Për një çikëz Amerikë”; “Lajthitje pleqërie”; “Radha ime të mbush xhepat”.

Filma dokumentarë ushtarakë: Ka qenë skenarist dhe realizues i filmave si “Skënderbegasit”, “Detaria shqiptare”, “Demontimi” dhe “5 Vjet në NATO”.

Librete komedie me Teatrin e Varietesë, Tiranë: “Qejflinjtë”, “Në sallën e gjyqit” “Dhuratë për ju”, “Rrumpallë show” dhe “Modeli” (2001).

Telekomedi: “Qejflinjtë”, “Një nuse e jashtme”, “Bobi”, “Një kandar nga Amerika”, “Sherrxhinjtë”, “Për një kokërr fik”.

Skenarist i videokasetave si “Hallall pensionin”, “Të na rrojë komshiu”, “Zotni Palloshi...”, “Obobo... na zunë ethet”, “Iku vapa me gushtin”.

Ka qenë skenarist për personazhe të emisionit “Portokalli” si Xha Temja, Aneja, Jorgaqi, dhe Terry, si dhe konsulent i serialit televiziv “Piruet”, me regji të Arjan Çuliqit.

Skenarist dhe shkrimtar i spektaklit “Alpazar”: Ka kontribuar në këtë spektakël nga viti 2012 deri në vitin 2024.

Çmime dhe Vlerësime

Agron Goga ka fituar çmime të rëndësishme për kontributin e tij në letërsinë satirike: Çmimi i Parë në Konkursin Mbarëkombëtar të Letërsisë Satiriko-Humoristike “Niko Nikolla”, për vëllimin me regjime “Si nuk u ngrit një bust për mua!”. Çmimi i parë në Konkursin

e Komedisë organizuar nga Teatri i Varietësë Tiranë me komedinë “Një formulë për një dyqan”.

Nëse në jetën ushtarake kërkohet seriozitet dhe përpikëri, Agron Goga ka treguar se edhe aty ka vend për një dozë të shëndetshme humori. Me një karrierë që shtrihet nga godina e Akademisë Ushtarake deri në skenat e humorit shqiptar, Goga është një zë i pazëvendësueshëm në satirën moderne shqiptare.

“Jeta më mësoi që ndonjëherë humorin e mëson nga lotët”

Z. Goga, përveçse ushtarak dhe shkrimtar, jeni edhe një njeri që keni kaluar një dhimbje të madhe personale. Si ka ndikuar



“AGRON GOGA ËSHTË NJË SHKRIMTAR, HUMORIST DHE OFICER I FORCAVE TË ARMATOSURA TË SHQIPËRISË, I NJOHUR PËR KONTRIBUTIN E TIJ TË PASUR NË LETËRSINË SATIRIKE DHE HUMORISTIKE SHQIPTARE. I LINDUR MË 2 NËNTOR 1961, NË ROSKOVEC TË FIERIT, AI KA NDJEKUR NJË KARRIERË TË GJATË USHTARAKE DHE ARTISTIKE.

“BASHKËSHORTJA IME ISHTE JO VETËM SHTYLLA E SHTËPISË, POR EDHE LEXUESJA IME E PARË. PAS LARGIMIT TË SAJ, GJITHÇKA U KTHYE NË HESHTJE. POR FËMIJËT E MI, DASHURIA PËR TA, MË MBAJTËN GJALLË. SOT, ÇDO VARG, ÇDO RRESHT I SHKRUAR, KA EDHE PAK NGA AJO QË NUK ËSHTË MË DHE SHUMË NGA ATA QË MË JAPIN FORCË TË VAZHDOJ.

kjo në krijimtarinë tuaj?

Është e vështirë të flasësh për humbje të tilla. Bashkëshortja ime ishte jo vetëm shtylla e shtëpisë, por edhe lexuesja ime e parë. Pas largimit të saj, gjithçka u kthye në heshtje. Por fëmijët e mi, dashuria për ta, më mbajtën gjallë. Sot, çdo varg, çdo rresht i shkruar, ka edhe pak nga ajo që nuk është më dhe shumë nga ata që më japin forcë të vazhdoj.

“Humori është mburojë, por nuk është arratisje”

Si ia dilni të shkruani humor edhe kur vetë përjetoni trishtim?

Sepse është mënyra ime për të qëndruar në këmbë. Kur shkruaj një parodi, kur ndërtoj një situatë komike, nuk po largohem nga realiteti, përkundrazi, po e përballoj me të vetmen armë që më ka mbetur: fjalën. Dhe ajo fjalë më ndihmon jo vetëm mua, por edhe lexuesin të kuptojë se jeta është e bukur edhe kur dhemb.



“Dashuria për fëmijët më mban të fortë, kur ndonjëherë do të doja vetëm të heshtja”

Cila është forca juaj sot, pas gjithë këtyre viteve?

Fëmijët e mi. Ata janë publiku im më kritik, por edhe më i sinqertë. Janë dritë në një botë që ndonjëherë errësohet. Për ta jetoj, krijoj, dhe mundohem të jem shembull i qëndrueshmërisë përballë jetës. Më kanë mësuar se dashuria nuk humbet, ajo vetëm ndryshon formë.

“Njeriu duhet të mësojë të qeshë edhe pas një lamtumire”

Çfarë keni mësuar për jetën në këto vite?

Që nuk kontrollojmë gjithçka, dhe nuk duhet. Shpesh duhet të falënderojmë çdo ditë që zgjohemi, çdo përqafim, çdo “të dua” që mund të themi. Sepse një ditë mund të mos kemi kohë. Kam mësuar të mos e shtyj dashurinë për nesër dhe ta ndaj buzëqeshjen edhe kur zemra më qan.

Ushtria e sotme ka nevojë për artin, po aq sa për armët. Jeni ende aktiv në Qendrën e Kulturës së FA? A ka vend arti në Forcat e Armatosura?

Absolutisht po. Arti është pjesë e moralit të një ushtari. Ai të ndihmon të reflektosh, të qëndrosh i lidhur me realitetin dhe me njerëzit. Kultura në FA është forcuar ndjeshëm dhe kjo është diçka që më gëzon.

Humori nuk shkruhet për të bërë të qeshin, por për të bërë të mendojnë. Çfarë do t’u thoshit të rinjve që duan të shkruajnë humor?

Të mos nxitohen për të bërë njerëzit të qeshin. Të vëzhgojnë jetën, të lexojnë dhe të jetojnë me njerëzit. Humori i mirë është ai që të bën të buzëqeshësh dhe të thuash: “Po kjo është e vërtetë!”. E atëherë je bërë shkrimtar.

Profili i një ushtaraku-shkrimtar si Agron Goga është dëshmi se arti nuk njeh uniformë, dhe se e qeshura është armë paqësore që shpon çdo dogmë. Vepra e tij është një pasuri që flet me gjuhën

SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE,
ANJEZA MUSOLLARI

Jemi në kohë kur sfidat globale të sigurisë po evoluojnë me shpejtësi, dhe kur përballjet gjeopolitike po zhvendosen gjithnjë e më afër kufijve tanë, nevoja për rritjen e kapaciteteve të brendshme të mbrojtjes është bërë më e domosdoshme se kurrë më parë. Në këtë kuadër, rivitalizimi i industrisë ushtarake shqiptare po shfaqet si një nga prioritetet strategjike që kërkon vëmendje të shtuar dhe një qasje të qartë të integruar ndërinstitucionale.

Një trashëgimi që rikthehet me synim të ri

Shqipëria ka trashëguar një infrastrukturë të konsiderueshme ushtarake nga e kaluara, përfshirë kapacitete prodhimi, riparimi dhe mirëmbajtjeje, të cilat për vite me radhë qëndruan jashtë funksionit. Me një analizë të kujdesshme tekniko-ekonomike dhe mbështetjen e partnerëve strategjikë, këto kapacitete mund të shndërrohen në bazamentin e një industrie moderne të mbrojtjes, e aftë të shërbejë si për nevojat kombëtare, ashtu edhe për ato të aleancave ndërkombëtare, përfshirë NATO-n.

Pse është kjo industri thelbësore sot?

Mbrojtje e qëndrueshme kombëtare. Në këndvështrimin tim nuk ka mbrojtje të qëndrueshme pa burime të brendshme që e mbështesin atë. Një industri ushtarake funksionale ul varësinë nga importi, siguron mirëmbajtje më të shpejtë të pajisjeve dhe ndihmon në përballimin më efikas të emergjencave ushtarake apo civile.

Ekonomi kombëtare dhe vende pune. Përtej përfitimeve strategjike, një industri e mirëorganizuar ushtarake mund të gjenerojë vlera të prekshme ekonomike: vende pune për inxhinierë, teknikë dhe specialistë; zhvillim teknologjik dhe partneritete me sektorin privat për nënkontraktime dhe shërbime të lidhura.

Diplomaci e mbrojtjes dhe kapacitet eksporti. Në një botë ku edhe siguria është pjesë e diplomacisë, të kesh produkte apo shërbime të eksportueshme në sektorin e mbrojtjes rrit prestigjin ndërkombëtar të vendit. Por kjo kërkon kritere të qarta etike dhe ligjore për përdorimin dhe destinacionin final të çdo produkti.

Roli i mediave të mbrojtjes: Informim dhe vlerësim me përgjegjësi

Gazeta “Ushtria” ka detyrën jo vetëm të pasqyrojë projektet në zhvillim, por edhe të informojë opinionin ushtarak dhe publik mbi ndikimet reale që sjell kjo nismë. Kjo analizë nxit një debat të matur dhe teknik, ku prioriteti mbetet gjithmonë interesi kombëtar dhe ruajtja e transparencës publike.

Një proces që kërkon koherencë, profesionalizëm dhe vizion

Rivitalizimi i industrisë ushtarake nuk është thjesht një projekt teknik apo ekonomik, ai është një gur themeli për sigurinë kombëtare. Ai kërkon bashkërendim të ngushtë midis Ministrisë së Mbrojtjes, Forcave të Armatosura, universiteteve teknike, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Shqipëria ka mundësi reale për të kthyer këtë industri në një aset strategjik dhe një motor zhvillimi. Ky proces nuk duhet parë si një luks, por si një komponent i domosdoshëm i sovranitetit dhe sigurisë kombëtare në një botë gjithnjë e më të paparashikueshme.

Benefitet dhe e ardhmja

Shqipëria dikur kishte një bazë të konsiderueshme prodhimi ushtarak gjatë regjimit komunist, por me rënien e sistemit dhe tranzicionin drejt ekonomisë

Rivitalizimi i Industrisë Ushtarake, një Qasje Strategjike në Realitetin e Ri të Sigurisë

së tregut, këto kapacitete u shkatërruan ose u lanë në harresë. Tashmë, ideja e rikthimit të një industrie moderne të mbrojtjes po shihet si një domosdoshmëri për përmbushjen e nevojave të ushtrisë dhe për të kontribuar në aleanca si NATO.

Benefitet kryesore të rivitalizimit të industrisë ushtarake: Siguri Kombëtare dhe Vetëmjaftueshmëri: Reduktimi i varësisë nga importi i armatimeve.

Reagim më i shpejtë në raste emergjente për furnizime, pajisje dhe mirëmbajtje.

Zhvillim Ekonomik dhe Teknologjik: Krijimi i vendeve të reja të punës për inxhinierë, teknikë, shkencëtarë dhe punëtorë të kualifikuar. Nxitje për zhvillim të teknologjive të avancuara që më pas mund të transferohen edhe në sektorë civilë.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Mundësi për partneritete me kompani dhe shtete të NATO-s për prodhim ose bashkë-prodhim. Fuqizimi i pozitës së Shqipërisë si një vend kontribuues aktiv në fushën e mbrojtjes në rajon. Modernizimi i Ushtrisë Shqiptare. Prodhimi i mjeteve të përshtatura për terrenin dhe nevojat specifike të Forcave të Armatosura Shqiptare. Lehtësi në mirëmbajtje dhe përmirësim të vazhdueshëm të sistemeve ekzistuese.

Si shihet e ardhmja e industrisë ushtarake në Shqipëri?

Transformimi i ish-fabrikave ushtarake, rindërtimi dhe modernizimi i ish-fabrikave në Poliçan, Gramsh, Mjekës dhe Burrel, investime publike ose përmes partneriteteve publike-private (PPP).

Integrimi në zinxhirët e furnizimit të NATO-s

Prodhimi i komponentëve për armë, pajisje mbrojtëse dhe pjesë këmbimi për tregjet e NATO-s.

Shqipëria ka një avantazh strategjik për të ofruar punë të kualifikuar me kosto konkurruese. Fokusi në teknologji të reja (dronë, komunikim, AI ushtarake); Bashkëpunime me universitetet dhe institutet kërkimore për zhvillim të dronëve ushtarakë, sistemeve të mbikëqyrjes dhe analizës së të dhënave me inteligjencë artificiale; Futja e prodhimeve të teknologjisë së lartë që nuk kërkojnë infrastrukturë të rëndë si dikur; Angazhimi i Diasporës dhe investitorëve strategjikë; Shfrytëzimi i dijes teknike dhe kapitalit të ekspertëve shqiptarë jashtë vendit për të ndërtuar një industri konkurruese.

Roli i ushtrisë shqiptare në këtë strategji:

Fokus në standardet e NATO-s: çdo zhvillim duhet të jetë i përputhshëm me doktrinën dhe logjistikën e NATO-s.

Trajnimi i specializuar: krijimi i kapaciteteve njerëzore që të mund të operojnë dhe mirëmbajnë teknologji të avancuar prodhimi dhe armësh.

Eksport potencial: nëse industria zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme dhe cilësore, Shqipëria mund të bëhet eksportuese e pajisjeve të caktuara ushtarake në rajon apo më gjerë.

Pengesat aktuale dhe sfidat: Mungesa e investimeve fillestare. Kuadri ligjor dhe procedurat e ngadalta të prokurimeve. Rreziku i korrupsionit në projektet strategjike. Nevoja për mbikëqyrje dhe transparencë në bashkëpunimet me kompani të huaja.

Rivitalizimi i industrisë ushtarake është një mundësi strategjike për Shqipërinë që kërkon vizion afatgjatë, investime të qëndrueshme dhe koordinim ndërinstitucional. Nëse zbatohet me kujdes dhe profesionalizëm, ajo mund të bëhet një shtyllë e fortë për zhvillimin ekonomik, fuqizimin e ushtrisë dhe për rolin gjeopolitik të Shqipërisë në rajon dhe në aleancat ndërkombëtare.



“Ma hoqën gjuhën për të më shpëtuar jetën... por me duart e mia, mësova të flas me botën”

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në histori, në tregime, në këngë popullore apo në heshtjet që nuk u shënuan kurrë në libra, gruaja ka qenë gjithmonë aty: duke mbajtur, duke sakrifikuar, duke luftuar. Guximi i saj nuk është gjithmonë i dukshëm, nuk bërtet si zërat e burrave nëpër tribuna, por ai është i thellë, i qëndrueshëm, i palëkundur. Guximi i gruas nuk është vetëm ai i luftëtares me armë në dorë. Është edhe ai i nënës që rrit fëmijë në errësirën e luftës. I vajzës që lufton paragjykimet për të ndjekur ëndrrat e saj. I gruas që ngrihet çdo ditë përballë një bote që shpesh përpigjet ta heshtë.

Mike, jeta na përball me situata që dhe në ëndrrat e një gjumi të thellë do të trembte, por realiteti si një ëndërr e keqe na sprovon dhe kjo ndodh me qenien më të fortë ‘Gruan’. Mua ,Ty, Ne.

“Isha vetëm 33 vjeç kur më dhanë lajmin që më ndau jetën më dysh: kancer në gjuhë”.

Nuk kisha pirë kurrë, nuk kisha tymosur... por sëmundja nuk pyet për zakonet tona. Ajo hyn pa trokitur.

Në fillim më thanë që një operacion i pjesshëm do mjaftonte. Por mjekët vendosën: duhej hequr e gjithë gjuha.

U zgjova nga operacioni me një djegie në fyt dhe një heshtje aq të rëndë, sa më thërrmoi shpirtin.

Të mos flisja më... ishte si të shihja jetën nga pas një xhami të mbyllur.

Muaj me radhë qava pa zë. Përpigjesha të kuptohesha, por shihja vetëm sy të hutuar përballë meje. Kur djali im i vogël më bënte një pyetje... dhe unë nuk mund t'i përgjigjesha...dhimbja nuk kishte britmë. Dhe një natë, bërtita brenda vetes. Atëherë kuptova: nuk doja të jetoja kështu. U regjistrova në një kurs intensiv të gjuhës së shenjave. Mësova me inat, me lot, me një uri të egër për të folur — ndryshe, por përsëri. Çdo fjalë që formonin duart e mia ishte një plagë që shërohej.

Sot mbaj konferenca motivuese, me ndihmën e përkthyesve dhe të duarve të mia. Jam gjallë. Jam nënë. Dhe jam zëri i atyre që besojnë se nuk kanë më zë.

Shkoj në shkolla, ndaj përvoja, mësoj se trupi flet me mijëra gjuhë... dhe më e rëndësishmja është kjo: fjalët që vijnë nga shpirti, prekin shpirtin.

Ndonjëherë, jeta të imponon heshtjen... që të zbulosh gjithçka që ke ende për të thënë.

Guximi në heshtje

Për shumë gra, guximi nis brenda mureve të shtëpisë. Atje ku askush nuk i sheh. Në netët pa gjumë me fëmijën në krah. Në ditët pa pushim, duke u kujdesur për gjithçka, duke sakrifikuar gjithmonë veten në fund të listës. Guximi i gruas shpesh ka qenë i nënvlerësuar, pikërisht sepse ai ndodh në mënyrë të heshtur. Por duhet guxim për të duruar. Duhet guxim për të qenë përkrahëse e një familjeje, për të sakrifikuar ëndrrat personale për një mirëqenie të përbashkët. A është më pak heroike gruaja që zgjedh të qëndrojë në shtëpi për të rritur fëmijët, sesa ajo që thyen barrierat në karrierë? Jo. Sepse guximi nuk matet me sytë e të tjerëve. Ai matet me përballjen me përgjegjësinë, me lodhjen, me vetminë.

Guximi përballë padrejtësisë

Shpesh, gratë kanë qenë në vijën e parë të ndryshimit, edhe kur bota u tha të heshtnin. Në çdo shoqëri, në çdo sistem që i ka nënçmuar, ato kanë gjetur mënyrën për të rezistuar. Edhe kur nuk u lanë të votojnë, ato mësuan të organizohen. Edhe kur nuk u lanë të arsimohen, ato shkruan në fshehtësi, lexuan me qiri, i mëkuan fëmijët me dije. Të jesh grua, është vetë një akt guximi. Të mos dorëzohesh përballë talljes, të mos e ulësh kokën kur të paragjykojnë për mënyrën si jeton, punon, dashuron, kjo kërkon guxim. Gruaja që ngrihet për të drejtat e saj, edhe kur e gjithë bota i kthehet kundër, është ndër figurat më të fuqishme që njeh njerëzimi.



GRATË KANË QENË NË VIJËN E PARË TË NDRYSHIMIT, EDHE KUR BOTA U THA TË HESHTNIN. NË ÇDO SHOQËRI, NË ÇDO SISTEM QË I KA NËNÇMUAR, ATO KANË GJETUR MËNYRËN PËR TË REZISTUAR. EDHE KUR NUK U LANË TË VOTOJNË, ATO MËSUAN TË ORGANIZOHEN. EDHE KUR NUK U LANË TË ARSIMOHEN, ATO SHKRUAN NË FSHEHTËSI, LEXUAN ME QIRI, I MËKUAN FËMIJËT ME DIJE. TË JESH GRUA, ËSHTË VETË NJË AKT GUXIMI.

Gruaja që bën epokë

Historia jonë është plot me emra burrash, por në sfond, gjithmonë ka qenë gruaja. Në kohën e luftës, kur burrat ishin në fronte, gratë ishin jo vetëm prapa skenave, por edhe në vijën e zjarrit. Në Luftën Nacionalçlirimtare, qindra gra shqiptare morën armët. Disa u bënë dëshmore, disa u burgosën, por të gjitha lanë një gjurmë. Nënë Tereza, një nga figurat më të ndritura shqiptare në botë, është një shembull i guximit shpirtëror. Në një botë që fliste për pushtet, ajo zgjodhi të fliste për dashuri. Në një botë që ndante, ajo zgjodhi të shërojë plagë, pa kërkuar asgjë në këmbim. Guximi i saj nuk ishte me zë të lartë, por ndikimi i saj kaloi kontinente.

Gruaja që përball vetveten

Por ndoshta forma më e vështirë e guximit është ajo e përballjes me vetveten. Gruaja që pas një sëmundjeje të rëndë, si në historinë e gruas që humbi zërin për shkak të tumorit, vendos

të mos dorëzohet, por të rikrijojë veten, është mishërim i guximit të pastër. Guximi për të mos u përkufizuar nga dhimbja, për të mos lejuar tragjedinë të bëhet identitet, është forma më sublime e fuqisë njerëzore. Guximi nuk është mungesë frike. Është veprim përballë frikës. Dhe kur gruaja përballlet me pasiguritë e jetës, me paragjykimet, me dhimbjen, dhe përsëri zgjedh të ngrihet, ajo po i jep botës një mësim mbi vlerën e jetës.

Guximi i gruas nuk është vetëm një histori që duhet treguar në 8 Mars. Është realiteti i përditshëm i miliona grave që nuk dorëzohen, që luftojnë për fëmijët, për familjen, për veten.

Është vajza që ngrihet kundër dhunës. Është nëna që sakrifikon gjithçka. Është gruaja që ecën përpara edhe kur rruga është e pashkelur. Guximi i gruas është thellësisht njerëzor. Është dritë në errësirë. Është forca që mban botën.

“Nëse do të njohësh forcën e vërtetë, shiko një grua që ka vendosur të mos ndalet”.

Zhvillimi i ekonomisë, i jetës, dhe i njohurive të shoqërisë në tërësi ka influencuar gjithmonë në përparimin e shkencës së parashikimit të motit, sepse, siç dihet, janë të pakta ato veprimtari të njeriut që nuk lidhen me reshjet, temperaturat, erërat etj. Por, një zhvillim të madh shkenca e meteorologjisë e pati me fillimin e fluturimeve ajrore.

Ekziston një lidhje tepër e ngushtë ndërmjet fluturimeve ajrore dhe shkencës së meteorologjisë, pasi kjo e fundit garanton kondita normale të fluturimeve kombëtare e ndërkombëtare. Edhe në vendin tonë zhvillimi i shkencës së meteorologjisë ka historikun e saj. Vlerat e para të elementeve meteorologjike janë matur, në vitin 1887, në qytetin e Shkodrës. Më pas kanë filluar të maten dhe në qytetet Durrës, Tiranë, Korçë e Vlorë. Por, këto vendmatje në të cilat punonin persona të huaj, priftërinj jezuit, nuk ishin dot në gjendje të formonin rrjetin e Shërbimit Meteorologjik.

Deri para çlirimit të vendit kishte vetëm një zyrë hidrografie pranë Ministrisë së Punëve Botore dhe një zyrë meteorologjike pranë Ministrisë së Bujqësisë. Një rrjet meteorologjik kombëtar, që do të përfshinte tërësinë e shërbimeve meteorologjike në të gjithë vendin, u arrit të krijohej në vitin 1949 nga Instituti i Shkencës. Për këtë qëllim, ishin montuar me kohë nëntë vendmatje të pajisura me aparatura normale të kohës dhe që ndodheshin në qytetet Shkodër, Kukës, Peshkopi, Durrës, Tiranë, Kuçovë, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë. Siç shihet vendmatjet ishin të shpërndara në të gjithë vendin, në vise e largësi të ndryshme, në kushte të ndryshme klimatike dhe në to punohej 24 orë në ditë.

Elementet meteorologjike të vrojtura në çdo stacion gjatë ditës ishin: diellzimi, shikimi horizontal, vranësi, drejtimi dhe shpejtësia e erës, presioni atmosferik, temperatura e ajrit dhe e tokës, lagështira, avullimi si dhe reshjet. Vrojtimi i vlerave të tyre bëhej i pjesshëm në çdo orë dhe i plotë në çdo tre orë. Gjithashtu, çdo ditë vetëm në Stacionin Qendror Tiranë punoheshin me dorë dhe analizoheshin katër harta sinoptike tokësore, të cilat shërbenin për të mbuluar me parashikim moti të gjithë territorin e vendit. Transmetimi dhe marrja e të dhënave meteorologjike si brenda ashtu edhe jashtë vendit bëhej çdo tre orë në Stacionin Qendror me sistemin mors nëpërmjet valëve radio. Bashkëpunimi me botën e jashtme realizohej nëpërmjet Qendrës Meteorologjike në Sofje të Bullgarisë dhe shërbente për të siguruar një fluturim normal mbi hapësirën ajrore të Shqipërisë dhe për të kontribuar në rrjetin e vrojtimit ndërkombëtar. Për herë të parë, pra në 1949, në këto vendmatje drejtimi dhe personeli ishin plotësisht shqiptar. Kështu në drejtim të Shërbimit ishte sinoptikani Pal Nikolli, për sektorin civil punonin sinoptikanët Petrit Leka, Nuri Bajko, Nazmi Daja dhe Seit Berisha, ndërsa sektori ushtarak përfaqësohej nga sinoptikani Hamit Kotoni. Këta sinoptikanë, që kishin studiuar në Jugosllavi, me profesionalizëm e përkushtim, kanë lënë gjurmët e tyre në historinë e Shërbimit Meteorologjik Kombëtar. Po në vitin 1949, u krijua Drejtoria e Shërbimit Meteorologjik në vartësi të Institutit të Shkencës. Ndërkohë personeli i rrjetit të shërbimit ka ardhur në rritje. Duhet përmendur puna e palodhur e vrojtuesve Nimete Zaka, Milla Përbilla, Albert Mërgjoni, Hamdi Shijaku, Zyber Dana etj., si dhe e teknikeve Marie Kristiqi, Myzejen Sokoli, Vitore Dushi, Fatime Mema etj.

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 411, të datës 2.11.1955, “Mbi riorganizimin e Shërbimit Meteorologjik të Shqipërisë”, u vendos që Shërbimi Qendror i Meteorologjisë në Tiranë e në qarqe të hiqet nga administrimi i Institutit të Shkencave dhe të kalojë në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shef i tij emërohet sinoptikani ushtarak Hamit Kotoni. Me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, Nr.1149, datë 26 dhjetor 1955, shërbimi meteorologjik kaloi në vartësi të Komandës së Aviacionit (MKA). Filloi kështu dhe historia e bashkëpunimit të ngushtë të Komandës së Aviacionit me Shërbimin Meteorologjik Kombëtar. Ky bashkëpunim ndikoi në modernizimin dhe shtimin e rrjetit ekzistues. Në këtë periudhë me punën e tyre kanë lënë gjurmë edhe sinoptikanët Engjëll Korça, Servet Minarolli, Minush Karalliu, etj., si dhe tekniket Rakibete Çuri, Vangjeli Korça, Myzejen Shehri, etj. Më 7 shtator 1956, me vendim të Këshillit të Ministrave Nr.377, pranë Shërbimit Meteorologjik është ngritur dhe Sektori i Aerologjisë. Krijimi i këtij sektori do të shërbente kryesisht për përcaktimin e lartësisë së reve, si dhe për përcaktimin e drejtimit të shpejtësisë së erës vetëm për qëllime ushtarake. Sipas këtij vendimi Stacioni Qendror (Sektori

Meteorologjia Ushtarake, Shtyllë Strategjike në Shërbim të Atdheut



i Aerologjisë) kishte për detyrë që të paktën dy herë në ditë të bënte sondimin e atmosferës, duke ngritur aero-sonda ose pilot-balona. Të dhënat që merreshin, shërbenin për të përgatitur buletin meteorologjik të AKA. Në vitin 1957 të nëntë stacionet e rrjetit të Shërbimit Meteorologjik të Aviacionit regjistroheshin në Organizatën Botërore të Meteorologjisë (WMO) me gjerësi e gjatësi gjeografike si dhe me lartësi mbi nivelin e detit. Kjo organizatë varej nga OKB dhe shteti ynë në bazë të konventave të vendosura prej saj, kishte detyrim kryerjen në rregull të vrojtimit meteorologjik si dhe përpilimin e telegrameve meteorologjike në stacionet meteorologjike të rrjetit, grumbullimin në Stacionin Qendror të këtyre telegrameve si dhe dërgimin e tyre nëpërmjet Bullgarisë në Qendrën Europiane të Meteorologjisë. Këto telegrame, që duhej të dërgoheshin çdo tre orë do të shërbenin për përpunimin e hartave sinoptike të parashikimit 24-orësh të konditave të motit. Gjithashtu, Shërbimi Meteorologjik i Aviacionit nëpërmjet valëve radio merrte informacion meteorologjik nga Qendra Evropiane

e Meteorologjisë. Nën drejtimin e Komandës së Forcave Ajrore, rrjeti i Shërbimit Meteorologjik është rritur vazhdimisht. Kështu, me krijimin e aeroporteve në vitin 1960 është krijuar Stacioni Sinoptik i Rinasit, me detyrë sigurimin meteorologjik të fluturimit të aviacionit ushtarak dhe atij civil në linjat ndërkombëtare. Ndërsa në vitin 1967, u krijua Stacioni Sinoptik i Farkës, me detyrë sigurimin meteorologjik të fluturimit të helikopterëve ushtarakë të Regjimentit të Helikopterëve Farkë, për t'u ndjekur më pas në vitin 1974, me krijimin e Stacionit Sinoptik të Gjadrit, me detyrë sigurimin e fluturimeve ajrore të Regjimentit të Aviacionit, Gjadër. Kështu, rrjeti i Shërbimit Meteorologjik Shqiptar nën drejtimin e Komandës së Aviacionit u kompletua dhe funksionoi në mënyrë aktive në përputhje me kërkesat e kohës. Për periudhën 1975 deri në 1990, në krye të Shërbimit Meteorologjik të Aviacionit emërohet ushtaraku Partizan Petroshati, i cili kishte studiuar për inxhinieri meteorologjike në Kinë. Prej vitit 1990 deri 1992, në krye të Shërbimit





Meteorologjik emërohet ushtaraku Minush Karalliu.

Cila ishte përbërja e rrjetit të Shërbimit Meteorologjik Shqiptar dhe si u përgjigjej ai kërkesave të kohës?

Rrjeti i këtij shërbimi përbëhej nga dymbëdhjetë stacione, të cilat ndaheshin në stacione pa sinoptikanë, ku bëheshin vetëm vrojtime dhe në stacione me sinoptikanë, ku bëheshin vrojtime dhe parashikime të motit.

Stacionet meteorologjike ku bëheshin vetëm vrojtime, që ishin stacionet Shkodër, Kukës, Peshkopi, Durrës dhe Korçë e kishin në përbërje e tyre: kopshtin meteorologjik me dimensione 26 me 26 metra, në të cilin ndodhej kafazi meteorologjik, termometrat që matnin temperaturën e tokës, anemometri që tregon shpejtësinë dhe drejtimin e erës, si dhe pluviometri që mat sasinë e shiut. Në kafazin meteorologjik ndodheshin: psikrometri i përbërë nga termometri i ajrit të thatë dhe termometri i ajrit të lagët, termometrat minimalë dhe maksimalë, higrometri që mat lagështirën specifike, si dhe termografi e higrografi, që tregojnë ecurinë ditore dhe javore të temperaturës dhe të lagështirës.

Zyra e vrojtimeve meteorologjike në të cilën ndodheshin barometri me zhivë dhe ai aneroid, që shërbejnë për të matur presionin atmosferik, barografi që tregon ecurinë ditore dhe javore të presionit atmosferik, tabelat psikrometrike, që shërbenin për llogaritjen e temperaturës së pikës së vesës dhe ditarët në të cilat shërbenin për regjistrimin e matjeve të elementeve meteorologjikë e për përpilimin e telegrameve meteorologjike. Ndërsa stacionet meteorologjike ku bëheshin vrojtime dhe parashikime ishin: Stacioni Qendror i Tiranës, i Rinasit, i Farkës, i Gjadrit, i Kuçovës dhe i Vlorës. Këto stacione kishin në përbërjen e tyre përveç kopshtit meteorologjik dhe zyrës së vërtetimit edhe zyrat e teknikës e të parashikimit të motit. Në zyrën e teknikës çdo tre orë merreshin me radiomarrëse, nëpërmjet Bullgarisë, të dhëna meteorologjike nga Qendra Europiane e Meteorologjisë. Këto të dhëna hidheshin me dorë nga teknikët në hartat sinoptike të parashikimit të motit, të cilat ishin tokësore dhe të lartësisë 850mb, 700mb, 500mb, 300mb dhe 200mb. Më pas këto harta kalonin në zyrën e parashikimit, ku pasi analizoheshin me dorë nga sinoptikanët d.m.th. pasi studiohej atmosfera në mënyrë tredimensionale arrihej në konkluzionin: Si është dhe si do të jenë konditat e motit për 24-orëshin e ardhshëm në vendin tonë dhe në kontinentin evropian. Në Stacionin Qendror të Tiranës bëhej grumbullimi i të gjitha të dhënave meteorologjike që vinin nga rrethet, si dhe përgatitej buletini meteorologjik, që i jepej fillimisht VKQ, MM, e më pas të gjitha dikastereve shtetërore, si dhe Radiotelevizionit Shqiptar.

Vlen të përmendet përfaqësimi me aq profesionalizëm e dinjitet që sinoptikani Petrit Leka i ka bërë me vite Shërbimit Meteorologjik në Televizionin Shqiptar deri në vitin 1990. Në Stacionin Qendror të Tiranës ndodhej dhe arkiva, në të cilën janë arkivuar që nga krijimi



i Shërbimit Meteorologjik të gjitha buletinet meteorologjike, hartat sinoptike si dhe punime të ndryshme shkencore. Shërbimi Meteorologjik i Aviacionit ka patur lidhje të ngushta me Institutin Hidrometeorologjik. Falë këtij bashkëpunimi u realizuan shumë punime shkencore e serioze në fushën e meteorologjisë. Shërbimi Meteorologjik i Aviacionit ishte ai që përgatiste rregullisht tabelat me vlerat e llogaritura të elementeve meteorologjikë, të cilat, së bashku me studime të tjera të këtij lloji, dërgoheshin në Institutin Hidrometeorologjik, ku përpunoheshin e më pas ribotoheshin, duke marrë kështu formën e studimeve shkencore. Si produkt i kësaj pune kolektive shkencore që nga viti 1956, të dhënat e Qendrës Meteorologjike të Aviacionit kanë ndihmuar në botimin e Buletinit Vjetor të Meteorologjisë. Në këtë botim nga ana e Shërbimit Meteorologjik përfshiheshin të dhënat vjetore sipas muajve, të vlerave të elementëve meteorologjikë të matura në vendmatjet meteorologjike, analiza e situatave të vështira sinoptike, etj.



Gjithashtu, në vitin 1978 do të botohej libri “Klima e Shqipërisë” dhe “Atlasi Klimatik i Shqipërisë”, një botim i pajisur me 120 harta, diagrame e tabela, në të cilat pasqyrohej shpërndarja e parametrave kryesorë të klimës shqiptare si: temperatura e ajrit, reshjet atmosferike, lagështia e ajrit, vranësia, diellëzimi, trysnia atmosferike, era dhe diagrama e temperaturës së tokës. Bashkëpunimi me Institutin Hidrometeorologjik ka vazhduar deri në vitin 1996. Duke pasur parasysh faktin që shtimi i vendmatjeve të elementeve meteorologjike ndihmon në parashikimin më me saktësi të konditave të motit, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes nr. 23, datë 12 Shkurt 1986, pranë reparteve ushtarake, u ngritën postat meteorologjike. Këto posta i jepnin Stacionit Qendror të Sinoptikës të dhënat përkatëse për temperaturën e ajrit, reshjet e shiut dhe të dëborës. Ndryshimi i sistemit politiko-shoqëror pas vitit 1991 ndikoi në funksionimin dhe strukturën e rrjetit të shërbimit meteorologjik.



Në këtë periudhë patëm reduktim të informacionit meteorologjik të ardhur nga rrethet në Stacionin Qendror për arsye të ndryshme si p.sh.: shkrirja e postave meteorologjike pranë reparteve ushtarake, shkatërrimi i linjave telefonike në disa rrethe, mungesë të fondeve financiare si për mirëmbajtjen e stacioneve, ashtu dhe për pagesë personeli. Kjo e fundit çoi në pakësimin e personelit në të gjithë rrjetin e për pasojë dhe heqjen e turnit të tretë në të gjitha stacionet e rrjetit. Në vitin 1996 me akt-marrëveshje ndërmjet ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit të Transportit shkëputet nga rrjeti i Shërbimit Meteorologjik i Forcave Ajrore stacioni i Rinasit dhe kalon në vartësinë e Ministrisë së Transportit. Trazirat e vitit 1997, krijuan dëmtime serioze në rrjetin e Shërbimit Meteorologjik me përjashtim të Stacionit Qendror. Në këtë stacion u ruajt çdo gjë dhe ajo që është më e rëndësishme, u ruajt arkiva pra, puna shumëvjeçare e bërë me aq profesionalizëm e përkushtim nga punonjësit e këtij shërbimi.

Për periudhën nga 1993 deri në 1998 në drejtimin e Shërbimit Meteorologjik ishte major Sherif Ymeri.

Në kuadrin e modernizimit të Forcave të Armatosura në tërësi, më 27 gusht 1997, është nënshkruar, në Romë, marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë Shqiptare të Mbrojtjes dhe Ministrisë Italiane të Mbrojtjes. Rezultat i kësaj marrëveshje ishte fillimi i zbatimit të projektit 403 ndërmjet Komandës së Forcave Ajrore dhe Delegacioni Italian i Ekspertëve (DIE) në Tiranë, më qëllim “Organizimin dhe modernizimin e Shërbimit Meteorologjik të Forcave Ajrore në përputhje me kërkesat e WMO”. Ky qëllim do të arrihej në dy linja paralele të cilat ishin: rritja e nivelit profesional të personelit të shërbimit dhe modernizimi i aparaturës e i metodave të punës në rrjetin e shërbimit. Rritja e nivelit profesional të personelit të shërbimit do të bëhej nëpërmjet kurseve të kualifikimit në Shqipëri dhe në Itali. Këto kurse, që kanë filluar që në vitin 1997 e që vazhdojnë edhe sot, janë të niveleve të ndryshme si “Osservatore meteo”, “Previsione junior” dhe “Meteorologia operativa”. Modernizimi i aparaturës do të bëhej nëpërmjet pajisjes me aparatura moderne të kohës e rrjetit ekzistues dhe kompjuterizimi i përpilimit të telegrameve meteorologjike e i shkëmbimit të informacionit meteorologjik si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Për këtë qëllim, nga viti 2000 e deri sot u kthyen në stacione moderne Stacioni Qendror Meteorologjik i Tiranës, si dhe Stacionet Meteorologjike Farkë, Gjadër, Kuçovë, Gjirokastrë e Kukës. Për herë të parë në këto stacione, për parashikimin e motit do të përdoreheshin pamjet satelitore “Meteosat 7” (VIS, IR dhe VW) si dhe modelet matematiko-numerike që janë shprehja e ligjeve dinamike e termodinamike të atmosferës me gjuhën e ekuacioneve matematike.

Për periudhën nga 1998 deri në 2001, Shërbimi Meteorologjik drejtohej nga kolonel Mexhit Taku. Ndërsa nga 2001 e në vazhdim Shërbimi Meteorologjik i Aviacionit drejtohet nga nënkolonel Bardhyl Imeraj. Në muajin mars 2003 transmetimi dhe marrja e informacionit meteorologjik filloi të bëhej nëpërmjet Qendrës Meteorologjike Italiane nëpërmjet programit “Prometeo”. Po në këtë vit stacionet Gjirokastrë e Vlorë kthehen në stacione automatike të tipit MAWS 301, ndërsa në Stacionin Qendror Tiranë instalohet radio HF për realizimin e komunikimit ndërmjet tij dhe stacioneve Farkë, Vlorë dhe Gjirokastrë.

Me urdhër të komandantit të Forcave Ajrore nr. 1993 datës 21 tetor 2003, në Stacionin Qendror të Tiranës filloi sistemi me tre turne. Në kuadrin e modernizimit të rrjetit të Shërbimit Meteorologjik, në shtator 2004 në Stacionin Qendror Tiranë është instaluar programi “Nubis”. Nëpërmjet këtij programi u realizua marrja e informacionit meteorologjik në mënyrë satelitore dhe po me anë të këtij programi, më 23 shtator 2004, filloi dhënia e informacionit të motit në televizionin publik shqiptar nga ana e Shërbimit Meteorologjik të Forcave Ajrore. Një arritje e madhe për Shërbimin Meteorologjik të Forcave Ajrore ishte dhe miratimi në Kuvend i ligjit nr. 9224, datë 29 prill 2004, si dhe rregullorja mbi organizimin dhe funksionimin e këtij shërbimi, miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes nr. 418, datë 28 qershor 2004, nëpërmjet të cilave përcaktohen qartë qëllimi, vartësia, organizimi si dhe detyrat e shërbimit meteorologjik ushtarak. Nga viti 2008 shumë televizione private apo edhe lokale transmetojnë të dhënat meteorologjike të marra nga Qendra Meteorologjike e Forcave Ajrore. Gjithashtu është duke u punuar për futjen e të dhënave meteorologjike në internet, ku të interesuarit do të marrin në kohë reale 24 në 24 parashikimin e motit.

Çlirimi i Një Kombi: Epopeja e Kosovës

Kur Troket Liria: Pranvera e Kosovës

Lufta në Kosovë mbetet plaga më e madhe e shqiptarëve. Mijëra të vrarë mbetën nga kjo luftë e shkaktuar nga forcat serbe, e cila kulmoi në vitin 1998 por kishte nisur shumë para këtij momenti.

Në këtë luftë u dëbuan 800,000 shqiptarë nga territoret e tyre, u vranë 15,000 njerëz, nga të cilët 2,400 luftëtarë të UÇK-së e të tjerët qytetarë të thjeshtë. Gjatë luftës janë zhdukur rreth 5,000 njerëz, fati i shumicës prej tyre është zbardhur deri në vitin 2007, por i madh ka mbetur numri i rasteve të pasqaruara.

Çlirimi i Kosovës, më 12 qershor 1999, është një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë moderne të shqiptarëve. Kjo datë shënon hyrjen e trupave të NATO-s në Kosovë, pas përfundimit të fushatës ajrore 78-ditore kundër forcave serbe dhe tërheqjes së ushtrisë dhe policisë serbe nga territori i Kosovës.

Çfarë ndodhi më 12 qershor 1999?

Trupat e NATO-s (KFOR) hynë në Kosovë për të vendosur paqen dhe për të garantuar sigurinë e popullsisë civile pas një lufte të përgjakshme që kishte zgjatur më shumë se një vit (1998–1999).

Forcat serbe u tërhoqën nga Kosova, si pjesë e marrëveshjes së nënshkruar më 9 qershor 1999, në Kumanovë, ndërmjet NATO-s dhe përfaqësuesve të ushtrisë jugosllave.

Luftëtarët e UÇK-së dhe qytetarët shqiptarë të Kosovës e përjetuan këtë si një ditë fitoreje dhe çlirimi nga një regjim shtypës dhe dhunues.

Konteksti historik

Lufta e Kosovës ishte një konflikt i armatosur mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe forcave serbe, i shoqëruar nga spastrime etnike, masakra dhe shpërngulje masive të shqiptarëve.

Pas dështimit të bisedimeve të Rambujesë dhe përkallëzimit të dhunës, NATO nisi një fushatë ajrore më 24 mars 1999.



Më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1244, e cila sanksiononte praninë ndërkombëtare në Kosovë dhe vendosjen e administratës së përkohshme të OKB-së (UNMIK).

Simbolika e 12 Qershorit

12 qershori konsiderohet Dita e Çlirimit të Kosovës dhe përkujtohet çdo vit si një ditë feste dhe nderimi për sakrificën e dëshmorëve dhe luftëtarëve të UÇK-së. Kjo datë është sinonim i fillimit të një epoke të re për Kosovën, rrugës drejt pavarësisë dhe ndërtimit të institucioneve demokratike.

Kosova duroi një prani të madhe të policisë sekrete gjatë gjithë viteve 1980, duke shtypur pa mëshirë çdo manifestim nationalist. Sipas një raporti të reporterit Mark Thompson, rreth 580,000 banorë të Kosovës u arrestuan, u morën në pyetje dhe u internuan.

Liria që Lindi nga Flaka

Çlirimi i Kosovës është një proces historik kompleks që përfshin dekada të tëra shtypjeje, rezistence, lufte dhe ndërhyrje ndërkombëtare. Ja një përmbledhje e shkurtër e mënyrës se si ndodhi çlirimi i Kosovës:



Shtypja nga regjimi i Serbisë (pas vitit 1989)

Pas heqjes së autonomisë së Kosovës nga Slllobodan Millosheviqi në vitin 1989, shqiptarët e Kosovës u përballën me shtypje sistematike: U pushuan nga puna masivisht. U mbyllën shkollat e pavarura shqipe, u ndalua përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe, Filloi një regjim policor dhe diskriminues.

Rezistenca paqësore, lëvizja e Ibrahim Rugovës



Në vitet 1990, nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës, shqiptarët ndërtuan institucione paralele, zhvilluan zgjedhje të veta dhe praktikuan rezistencë paqësore. Megjithatë, kjo nuk solli ndaljen

e represionit serb.

Formimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)

Nga mesi i viteve '90, ndjenja se rezistenca paqësore nuk po jepte rezultat çoi në formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), që synonte çlirimin e Kosovës përmes luftës së armatosur.

Lufta e Kosovës (1998–1999)

UÇK ndërmori aksione të armatosura kundër forcave serbe. Forcat serbe nisën një fushatë të dhunshme kundër shqiptarëve të Kosovës, përfshirë djegie fshatrash, masakra, dhunime dhe shpërngulje masive. Këto veprime u dënuan nga bashkësia ndërkombëtare.

Ndërhyrja e NATO-s (Mars–Qershor 1999)

Më 24 mars 1999, NATO filloi bombardimet kundër forcave serbe në Kosovë dhe në Serbi, pas refuzimit të marrëveshjes së Rambujesë nga Millosheviqi. Fushata zgjati 78 ditë.

Çlirimi dhe hyrja e trupave ndërkombëtare

Më 10 qershor 1999, Serbia pranoi tërheqjen e forcave të saj nga Kosova. NATO dhe OKB morën kontrollin e Kosovës. Më 12 qershor 1999, trupat paqeruajtëse të KFOR-it hynë në Kosovë. U vendos administrata e përkohshme e OKB-së (UNMIK).

Pas çlirimit

Filloi rindërtimi institucional dhe përgatitja drejt vetëqeverisjes. Më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë, por procesi i çlirimit real nisi më 1999, me largimin e forcave serbe.



Qafa e Gjashtës e Luftës, Burrërisë, Trimërisë dhe Dëshmorëve



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Homazh për të gjithë të rënë dhe dëshmorët që e derdhën gjakun për Atdheun në qafë Gjashtë në të gjitha periudhat historike në dy shekujt e fundit

Kur shikojmë qafat, malet, kreshtat, bregoret, i konceptojmë gjeografikisht në këndvështrimin tokësor, ndërsa kur vijmë nga deti perceptohen ndryshe. Majat e maleve shfaqen fillimisht, më tej malet ku mbështetet gjithë konfiguracioni gjeografik. Relievat dhe gjithë konceptimi gjeografik gjendet në tekstet e gjeografisë nga Aristoteli, Straboni, Kristofer Kolombi, Magelani, Vasko de Gama etj. Ndërkohë që ushtarakët nëpër shekuj e kanë shikuar relievin në pikëpamje luftarake, “për sulm, mbrojtje, marrshim, kurthe, prita, kundërsulme, kundërgoditje, për thellësinë luftarake, skalionimin, artilerinë, aviacionin, dronizimin, vështrimin hapësinor, etj. Ndërsa në konceptin gjeografik relievi i shërben kalimit të qafave, shpateve, maleve, kurrijeve etj. Qafat e kodrinave, maleve kanë shërbyer dikur si “pusi hajdutësh”, pasi nëpër to kalonin rrugët që shërbenin si porta hyrëse, por edhe si vija ndarjeje e bashkuese të territoreve, edhe pse qafat në maja malesh paraqesin një ulje të vijës kreshtore midis majave kryesisht nëpër male. Kështu nëse marrim trevën labe gjejmë pesë porta kryesore hyrëse, por ky fenomen ndodh njësoj në të gjithë shtrirjen e kufirit administrativ shqiptar të “Shqipërisë londineze” dhe përtej saj kudo flitet shqiptarçe.

Në përditshmërinë tonë, na ka takuar të kalojmë qafa të shumta, sikurse është edhe qafa e Skërficës, qafa e Livadhit dhe tej në horizont duket edhe qafë Gjashta e për rrjedhojë edhe fshati “Gjashtë”. Si rrallë herë emërtimin e fshatit ja ka dhënë “Qafa e Gjashtës”, që pothuaj nuk ekzistonte si fshat në betejën e qafë Gjashtës, ku ranë 46 zhulatas dhe 10 fushëbardhas, por edhe dhjetëra të tjerë burra luftëtarë që u derdhën kundër armikut zaptues që vinte nga deti. Zhulati e pagëzoi Gjashtën në këngë, “Në Gjashtë u vranë zhuletë”, Fushëbardha iu shkroi biografisë të dhjetë të rënëve që ranë në Gjashtë dhe që deri para 35 vitesh ishin në muzeun e fshatit Fushëbardhë. Kur i këndonin Gjashtës natyrshëm i këndonin bijve që e pritën armikun me pushkë, natyrshëm siç e kanë pritur çdo herë. Kur flasim për të rënë dhe shumë në këtë qafë, gjithkujt i shkon mendja se pse ky emër në këtë qafë, “qafa e Gjashtës”, që ka pasur dhe ka “çelësat” për të hyrë në qytetin e Sarandës.

Në një territor të thyer e malor qafat janë të shumta dhe kanë shtrirje territoriale 360-gradëshe. Qafa e përjetshme nga të sjell në Gjashtë pikë së pari është ajo që vjen nga Qafa e Muzinës, një portë natyrore që lidh e bashkon fushën e Drinos të Libohovës e Gjirokastrës, me atë të Delvinës e Sarandës. Më në veri dhe e dyta në radhë është qafa e Skërficës, që ia rriti vlerën si qafë infrastruktura rrugore, aksit më të ri rrugor Kardhiq-Delvinë-Sarandë i përfunduar dhe inauguruar më 2 korrik 2022, me një gjatësi 1316 metra. Në planin historik qafa e Skërficës ka shërbyer si i vetmi kalim i shkurtër i ushtrive gjatë luftërave iliro-romake në antikitet, i karvanëve tregtare, që zbrisnin nga Bejlerbellëku i Kardhiqit në Pashallëkun e Nahijes së Delvinës, gjatë mesjetës. Nga kjo qafë më afër janë Mali i Lucës, Mali i Pyllloit dhe Mali i Gjerë. Në Skërficë është zhvilluar një prej luftërave më të njohura në përballje me andartët grekë, duke e gozhduar ushtrinë greke për një javë, duke i hequr çdo mundësi kalimi. Më në Jug pranë Konispolit është qafa e Botës, e njohur dhe e përdorshme si porta më e afërt tokësore e kalimit kufitar me Greqinë.

Rruga automobilistike e qafë Botës është çelur nga njësitë e punës xheniere e ushtrisë italiane, kur erdhën si pushtues, më 7.4.1939. Ata kishin ndërtuar e kaluar rrugë që nga pushtimet e antikitetit, të rrugës “Egnatia” që kalon në dhjetëra qafa, edhe para e gjatë Luftës së parë Botërore. Qafa e Sopotit është pjesë e qafëmaleve që ngrihen në rajonin lindor të Delvinës, ku qafa e Sopotit, nga mesjeta deri në fillim të shekullit të kaluar para më shumë se njëqind vitesh kanë kaluar karvanët e tregtisë, që shkëmbenin mallrat midis Delvinës, Janinës e deri në Gjirin e Artës, Ambrakisë, Çamëria, Gjirokastrës etj.

Qafa e Gjinës, është një prej portave hyrëse në fshatin Shelegar,



një fshat që mendohet se është njëshekullor, i populluar fillimisht nga një duzinë familjesh nga treva çame. Kur kemi përshkruar pesë qafa që të hysh në këtë trevë në radhë është një qafë që quhet natyrshëm “qafa e Gjashtë”, prej nga rrjedh edhe emërtimi gjeografik i këtij fshati që ngjan më shumë si një lagje qyteti të Sarandës, ose si një istikam në shpinë të Sarandës që duket se është e vendosur në një hapësirë gjeografike për ta mbrojtur nga shpina qytetit e hireve të Sarandës. Shumëkush e quan Gjashtën si një “zgjatim e urbanizim i qytetit të Sarandës. Realisht është një përbashkim i natyrshëm, ku toka është shumë e shtrenjtë dhe e shenjtëruar në epokën e bumit turistik. Logjika e urbanizimit nuk mund të harrojë dhe të nënvleftësojë mbijetesën e Gjashtës si qafë dhe më tej si fshat, sepse këtu në Gjashtë është zhvilluar një ndër betejat më të famshme të historisë, ku themelet e saj janë realisht mbi themelet e gjakut të të rënëve, edhe atyre që në ndonjë fshat i ka pluhurosur historia dhe kujtesa dritëshkurtër edhe të intelektualëve që nuk kanë mundur dhe nuk kanë ditur të vlerësojnë bijtë e rënë për atdheun.

Në gjashtë është vetëm një memorial që nuk ka zënë asnjë metër tokë, por pllakata gjithsesi flet për të rënë gjatë LANÇ-it në këtë qafë. Me të drejtë është folur dhe shkruar në pllakatë për të rënë që erdhën nga të pesë qafat për të mbrojtur të Gjashtën, Qafën e Gjashtë dhe në pllakatë ndrijnë emrat e dëshmorëve: Anife Heta, Ali Gorica, Dhurim Hajdini, Idriz Hici, Isa Zhuli, Kosta Karkashina, Kristo Karkashina, Miho Gjino, Sefer Kushi, Sinan Bllaci, Thanas Koçi, Thona Roze, Zeqir Deho, Zoto Buzo (14 dëshmorët që ranë në Gjashtë për çlirimin e Sarandës, ndërkohë që janë 145 dëshmorë të evidentuar në pllakën prej mermeri me mbishkrimin për secilin dëshmor, restauruar për nder të 80 vjetorit të çlirimit) që janë në të vërtetë rrënjët e vetë lirisë shqiptare.

Por këtu në Gjashtë u derdh gjaku i 46 të rënëve nga Zhulati historik, që kënga për ta e ka kapërcyer shekullin dhe këndohet valle burrërishte në shumë festa e gëzime, por dhe festivale. Nuk do të ishte e udhës që në këtë qafë të trupëzoheshin emrat me një memorial dinjitoz që të flasë edhe me një basoreliev të spikatur për luftën e gjashtës për 46 mandatët. Ne kemi mundur të dallojmë dhe të nxjerrim nga sirtarët e pluhurosur të historisë nga ish- muzeu i fshatit Fushëbardhë si dhe nga të dhënat e shumë bashkëfshatarëve intelektualë që e kanë shkruar historinë sa kanë mundur dhe sa kanë ditur. Kështu Fushëbardha dërgoi çetën bashkë

me Zhulatin dhe gjithë fshatrat e Labërisë por edhe nga gjithë treva përreth, kur binte briri i Luftës. Nga Fushëbardha ranë dhe ngelën të trupëzuar me Gjashtën, duke e bërë më të fuqishme këtë qafë: Abedin Bilal Muho (1852-1878), Hair Idriz Stefani (1840-1878), Idriz Ymer Alidhima (1830-1878), Kasëm Xhafer Gjoni (1845-1878), Mato Asllan Asllani (1847-1878), Osman Jaho Deçka (1848-1878), Sali Sabri Isufi (1850-1878), Seit Selman Dobro (1850-1878), Shahin Muhamet Veliu (1848-1878), Shahin Shaban Memo (1848-1878). Por kjo listë meriton të plotësohet dhe të kompletohet pasi nga të dhënat e Mersin Velishan Peçit më 1878 në qafë Gjashtë ranë edhe dy djemtë e plakur 112 vjeçar Medi Peçi Musa Medi Peçi dhe Resul Medi Peçi, që u vranë në qafë Gjashtë, në kohën që Nurçe Medi Peçi dhe Avdul Medi Peçi ishin duke bërë nizamllëkun në Anadoll.

Fisi Peçi pati edhe të rënë të tjerë për Atdheun sikurse ishte Muslim Çano Peçi, ndërsa Velishan Isa Peçi kishte marrë pjesë me armë në dorë në luftën e Skërficës kundër andartëve, por edhe pas në luftën e madhe të Vlorës. Në fushë të Delvinës në kohë pushtimesh kanë ndodhur ngjarje e përballje luftarake të njohura. Kështu bijtë e Fushëbardhës kanë kaluar qafën e Skërficës, janë përballur në qafë Gjashtë, por edhe në luftën e Palavlisë, më 1878 në krahinën e Rrëzomës afër Delvinës, ku kanë rënë Skëndo Xhuvani, Myrteza Sulli, Musa Mustafa Rofi, Sadik Hazbi Memushi, ndërsa Hito Muhamet Kongoci-Fushëbardha ka rënë në Koqinovë të Rrëzomës. Në Skërficë kaluan edhe bijtë e Fushëbardhës që shkuan në mbrojtje të Vilajetit të Janinës në luftën e katërt dhe të fundit për Janinën në mars 1913, ku kanë rënë Rustem Shalari, Muho Godo Cama, Resul Peçi, Islam Zyber Kondi, që ranë në betejë në Bezhani dhe Grebene në Janinë. Fshatrat e Labërisë e shkruan bashkërisht historinë e luftës, burrërisë, trimërisë, lavdisë, kaluan qafa e gërxhe, ja mbërritën të shkruanin epope dhe ta detyronin armikun të nënshtrohej dhe të nënshkruante kapitullimin. Prandaj bijtë e bijat e fshatrave të Labërisë janë në pedestal të nderit të lavdisë, sepse luftuan për lavdinë kombëtare për interesin kombëtar. Detyrimi ynë është të lartësojmë këto vende dhe këto qafa të shenjta, ku shqiptarët shkruan realisht histori, ku dëshmorët janë mbartësit e historisë. Edhe për shqiptarët si për çdo komb të qytetëruar në botë dëshmorët janë lavdia e krenaria e tij, janë vlerat më të çmueshme, që nderohen nga të gjithë dhe ngelen burim frymëzimi për brezat e rinj.

Inovacioni në teknologjinë e mbrojtjes është moment vendimtar i Evropës

Ukraina ka treguar se lufta moderne është një bashkim i Luftës së Parë Botërore dhe Luftës së Tretë Botërore - duke kombinuar luftën në llogore me teknologjitë më të përparura. Evropa tani duhet t'i zotërojë të dyja.

Mark Boris Andrijanič është ish-ministri për Transformimin Dixhital të Sllovenisë. Ann Mettler është ish-drejtoreshë e Përgjithshme në Komisionin Evropian. Ata kanë dekada përvojë në politikat evropiane të teknologjisë dhe inovacionit.

Imagjinoni dronë autonomë që godasin objektivat e armikut në tokë, në det dhe në ajër; sulme kibernetike që ndërpresin linjat jetësore të furnizimit; dhe trupa në vijën e parë që përdorin inteligjencën artificiale për të planifikuar sulmin e tyre të ardhshëm. Kjo nuk është një skenë nga një thriller futurist - është realiteti i luftës në Ukrainë sot.

Ndërsa agresioni i Rusisë i afrohet kufijve të BE-së dhe aleanca transatlantike dobësohet, Evropa ndodhet në një pikë kthese. Pas viteve të neglizhencës, buxhetet e mbrojtjes më në fund po rriten ndjeshëm - por nëse performanca e kaluar është ndonjë tregues i rezultateve të ardhshme, ka arsye për shqetësim.

BE-ja ka derdhur qindra miliarda në axhenda dixhitale dhe të gjelbra, të mbështetura nga ambiciet dhe aspiratat e guximshme të lidershit global. Megjithatë, ajo mbetet shumë e varur nga softueri amerikan dhe hardueri kinez, nga panelet diellore te bateritë. Kjo zbulon një të vërtetë të ashpër: vetëm, shpenzimet nuk garantojnë inovacionin, dhe në mbrojtje, dështimi nuk do të jetë vetëm i kushtueshëm - mund të jetë fatal.

Kjo është arsyeja pse Evropa ka nevojë urgjente për një plan gjithëpërfshirës të lojës, një plan që mëson nga gabimet e së kaluarës dhe parashikon nevojat dhe mundësitë e ardhshme. Dokumenti i Bardhë i Komisionit Evropian për Mbrojtjen dhe iniciativat e fundit - veçanërisht Instrumenti SAFE - ofrojnë një bazë të fortë. Me rëndësi, këto përpjekje njohin se riarmatimi i Evropës duhet të jetë po aq shumë për politikën industriale dhe teknologjike sa edhe për vetë mbrojtjen.

Prioriteti i parë duhet të jetë një treg i përbashkët i unifikuar për mbrojtjen, i ankoruar në BE, por që shtrihet në partnerë kryesorë si Mbretëria e Bashkuar, Norvegjia, Zvicra dhe Ukraina. Një audit rregullator është thelbësor për të përcaktuar nëse kornizat ekzistuese - nga ESG dhe mbrojtja e të dhënave deri te taksonomia - krijojnë barriera të panevojshme, veçanërisht për teknologjitë me përdorim të dyfishtë që shpesh zhvillohen nga startup-et. Standardet dhe ndërveprimi i përbashkët janë të nevojshme për të shkallëzuar inovacionin, për të nxitur konkurrencën dhe për të mbyllur boshllëqet e aftësive, ndërsa prokurimi i përbashkët do të ndihmonte në uljen e kostove.

Qëllimi përfundimtar duhet të jetë një ekosistem plotësisht i integruar që krijon kampionë evropianë të mbrojtjes të aftë për të konkurruar globalisht. Aktualisht, vetëm një kompani evropiane, "BAE Systems" e Mbretërisë së Bashkuar, shfaqet në dhjetë firmat më të mira globale të mbrojtjes. "Rheinmetall" i Gjermanisë renditet vetëm i 26-ti, sipas Institutit Ndërkombëtar të Kërkimeve për Paqen në Stokholm (SIPRI).

Së dyti, zhblokimi i investimeve private dhe institucionale është thelbësor. Stigma që grupon sipërmarrjet e mbrojtjes dhe ato me përdorim të dyfishtë me industri si duhani, duhet të zhduket shpejt. Institucionet financiare kanë nevojë për udhëzime të qarta rregullatore për të investuar me besim në industrinë evropiane të mbrojtjes.

Së treti, rregullat dhe procedurat e ngadalta të prokurimit të mbrojtjes në Evropë duhet të përshtaten me ciklet e inovacionit të sotëm, shpesh vetëm disa muaj - veçanërisht në fusha si zhvillimi i dronëve. Sektori i mbrojtjes ka një avantazh kyç: ndryshe nga industritë civile, të cilat kanë tendencë të rregullohen shumë, ai mund të vendosë me shpejtësi zgjidhje inovative. Ky avantazh tani duhet të shfrytëzohet përmes testimit dhe shkallëzimit të shpejtë. Për ta mundur këtë, ekipet e prokurimit duhet të operojnë në ballë të teknologjisë, gjë që kërkon përmirësimin e aftësive dhe integrimin e tyre me teknologë. Për më tepër, një klauzolë preferenciale evropiane duhet të përfshihet në prokurimin e mbrojtjes, duke i dhënë përparësi furnizuesve vendas sa herë që është e mundur.

Së katërti, Evropa ka nevojë për një qasje ekosistemi ndaj inovacionit në mbrojtje - një qasje që nxit në mënyrë aktive bashkëpunimin midis aktorëve të vendosur të industrisë, startup-eve dhe kompanive të shkallëzuara, investitorëve, qeverive dhe institucioneve kërkimore. Politikëbërësit shumë shpesh ndjekin një qasje ndaj industrisë dhe një tjetër ndaj startup-eve, kur sekreti i suksesit është



bashkëpunimi midis të dyjave.

Duhet të krijohet një platformë e dedikuar bashkëpunimi që përqendrohet në iniciativa strategjike dhe mbështetet nga stimuj për projekte të përbashkëta dhe transferim teknologjish. Një iniciativë e tillë mund të jetë lançimi i një "muri dronësh" përgjatë Krahut Lindor: një vendosje e koordinuar e tufave autonome të dronëve për mbikëqyrje dhe mbrojtje.

Së pesti dhe së fundmi, Evropa ka nevojë për versionin e saj të DARPA-s - një agjenci publike inovacioni të guximshme, të orientuar drejt sfidave, që mbështet kërkime me rrezik të lartë dhe shpërblim të lartë për të ofruar përparime të rëndësishme në teknologjitë e përdorimit të dyfishtë dhe të mbrojtjes. Kjo do të kërkojë transformimin e Fondit Evropian të Mbrojtjes në një institucion me burime më të mira, më të shkathët dhe të orientuar drejt misionit.

Për të ndihmuar në udhëheqjen e këtyre përpjekjeve transformuese, BE duhet të krijojë një Këshill Evropian të Inovacionit të Mbrojtjes - një organ i nivelit të lartë, i pavarur që ofron këshilla strategjike për Komisionin Evropian dhe Shtetet

Anëtare mbi teknologjitë në zhvillim që lidhen me mbrojtjen. Modeli është Bordi i Inovacionit të Mbrojtjes i SHBA-së, i krijuar në vitin 2016 dhe i kryesuar për herë të parë nga ish-CEO i Google, Eric Schmidt. Ai luajti një rol kyç në formësimin e strategjisë së inovacionit të Pentagonit, duke përfshirë praktikën më të mira nga Silicon Valley dhe duke përshpejtuar miratimin e teknologjive të përparura, veçanërisht AI-në.

Lajmi i mirë për Evropën është se inovatori kryesor i mbrojtjes në botë është tashmë midis nesh, dhe në anën tonë - Ukraina. Pavarësisht presioneve të forta të kohës së luftës, vendi është shfaqur si një lider në teknologjinë e dronëve, luftën kibernetike dhe integrimin e inteligjencës artificiale në fushën e betejës. Në kontrast me modelin e ngadaltë dhe të kushtueshëm të Evropës së inovacionit gradual, Ukraina shkëlqen në inovacionin e kursyer për të ofruar me shpejtësi zgjidhje të shkallëzueshme, me kosto efektive dhe me ndikim të lartë. Çuditërisht, tani prodhon mbi 150,000 dronë në muaj, duke tejkaluar të gjithë BE-në.

Shpesh thuhet se ata që duan paqe duhet të përgatiten për luftë. Për Evropën, kjo do të thotë të shkëputen nga e kaluara dhe të ndërtojnë një ekosistem mbrojtës të aftë për të ofruar teknologji të përparura me shpejtësi dhe shkallë. Përpjekjet e fundit të Komisionit Evropian përfaqësojnë hapa të guximshëm në drejtimin e duhur, por progresi i vërtetë do të varet nga përpjekjet e koordinuara institucionale, bashkëpunimi i thellë me komunitetin teknologjik të Evropës dhe një ndryshim themelor në mentalitet.

Ukraina ka treguar se lufta moderne është një bashkim i Luftës së Parë Botërore dhe Luftës së Tretë Botërore - duke kombinuar luftën në llogore me teknologjitë më të përparura. Nëse Evropa nuk mëson t'i zotërojë të dyja, siguria, sovraniteti dhe vetë mbijetesa e saj do të jenë në rrezik.

Inovacioni në teknologjinë ushtarake ka transformuar mënyrën se si zhvillohen konfliktet dhe si mbrohen kombet. Me avancimet në inteligjencën artificiale, sistemet autonome dhe armët me precizion të lartë, teknologjia ushtarake po bëhet gjithnjë e më e sofistikuar dhe e fuqishme.



Shefi i NATO-s, thotë se një rritje prej ‘400%’ e mbrojtjes ajrore dhe raketore është e nevojshme për të mbrojtur Evropën nga Putini dhe për t’u bërë ‘një aleancë më vdekjeprurëse’

Kreu i NATO-s, Mark Rutte, bëri thirrje të hënën për një “kërcim kuantik” në kapacitetet mbrojtëse, duke përfshirë një “rritje prej 400%” në mbrojtjen ajrore dhe raketore, e cila “mbron” aleancën nga Rusia.

“Ne shohim në Ukrainë se si Rusia shpërndan terror nga lart, kështu që do të forcojmë mburojën që mbron qiellin tonë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Rutte, në një fjalim në organizatën kërkimore “Chatham House” në Londër, sipas komenteve të publikuara në një deklaratë.

Për të ruajtur frenimin dhe mbrojtjen e besueshme, NATO-s i duhet “një rritje prej 400% në mbrojtjen ajrore dhe raketore”. “Fakti është se na duhet një hap i madh në mbrojtjen tonë kolektive”, do të thoshte ai.

“Mendimi i dëshiruar nuk do të na mbajë të sigurt. Nuk mund ta largojmë rrezikun me ëndrra. Shpresa nuk është strategji. Pra, NATO duhet të bëhet një aleancë më e fortë, më e drejtë dhe më vdekjeprurëse”.

Rutte do të takohet me Kryeministrin e Mbretërisë së Bashkuar Keir Starmer të hënën përpara fjalimit të tij, bisedimeve të tyre të dyta në Downing Street që kur Starmer erdhi në pushtet në korrik 2024.

Ashtu si anëtarët e tjerë të NATO-s, Mbretëria e Bashkuar ka rivlerësuar shpenzimet e saj të mbrojtjes që nga pushtimi i plotë i Ukrainës nga Rusia në shkurt 2022. Starmer është zotuar të rrisë shpenzimet britanike të mbrojtjes në 2.5% të produktit të brendshëm bruto deri në vitin 2027 dhe në 3% deri në vitin 2034.



Lëshimi i raketës ruse “Yars” në tetor 2022

Rutte ka propozuar një objektiv prej 3.5% të prodhimit ekonomik për shpenzimet ushtarake dhe 1.5% të tjera për ‘shpenzimet që lidhen me mbrojtjen’, siç janë rrugët, urat, aeroportet dhe portet detare. Ai tha javën e kaluar se është i bindur se aleanca do të bjerë dakord për objektivin në samitin e saj në Hagë më 24-25 qershor. Për momentin, 22 nga 32 vendet anëtare e përbushin ose e tejkalojnë objektivin aktual prej 2% të NATO-s.

Shefi i NATO-s, Rutte: Rritje prej ‘400%’ të mbrojtjes ajrore dhe raketore



Komentet e tij vijnë përpara një samiti të NATO-s në Holandë këtë muaj. Presidenti amerikan Donald Trump po u bën presion anëtarëve të aleancës që të njoftojnë një rritje të madhe në buxhetet e tyre ushtarake.

Ai po i shtyn anëtarët e NATO-s të rrisin shpenzimet e tyre të mbrojtjes në pesë për qind të produktit të tyre të brendshëm bruto (PBB), nga objektivi aktual prej dy për qind.

Sekretari i Mbrojtjes i SHBA-së Pete Hegseth tha javën e kaluar në Bruksel se aleatët ishin afër një marrëveshjeje për objektivin prej pesë për qind, i cili mund të formalizohej në samitin në Hagë.

Anëtarët e NATO-s janë përpjekur të forcojnë aftësitë e tyre mbrojtëse që kur Rusia nisi luftën e saj kundër Ukrainës në

shkurt 2022. “Rreziku nuk do të zhduket as kur të mbarojë lufta në Ukrainë”, - tha Rutte.

“Ne duhet të kemi më shumë forca dhe aftësi për të zbatuar plotësisht planet tona të mbrojtjes. Ushtritë tona gjithashtu kanë nevojë për mijëra automjete të blinduara dhe tanke, miliona predha artilerie”.

Britania njoftoi javën e kaluar planet për të ndërtuar deri në 12 nëndetëse sulmuese me energji bërthamore dhe gjashtë fabrika municionesh për të riarmatosur vendin në përgjigje të asaj që i quajti kërcënime nga Rusia.

Më parë këtë vit, qeveria e Starmer u zotua të rrisë shpenzimet e mbrojtjes në 2.5 për qind të PBB-së deri në vitin 2027, por ende nuk ka vendosur një afat kohor të saktë për rritje të mëtejshme.



Avioni luftarak F16 i Forcave Ajrore Mbretërore të Holandës duke u ngritur

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2025–2026:

60 (gjashtëdhjetë) të drejta studimi,
sipas specialiteteve:

- Ndërlidhje, 15 Kuota
- Logjistikë, 7 kuota
- Inxhinieri, 10 kuota
- Xhenio/Infrastrukturë, 5 kuota
- Mjekësi, 3 kuota
- Shkenca mjekësore, 2 kuota
- Kimi, 5 kuota
- Këmbësori, 13 kuota

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit:

deri më **29 gusht 2025**

Për informacion kliko në linkun:

<https://shorturl.at/o6Yvy>